



## Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave  
Ministry of Local Government Administration

<b>Për :</b>	<b>Ragip Begaj, Kryetar i Komunës së Malishevës</b> <b>Rrahim Morina, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës</b>	
<b>Cc:</b>	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
<b>Përmes:</b>	<b>Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së</b> <b>Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së</b>	
<b>Nga:</b>	<b>Shkelqim Jakupi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL</b>	<b>Data:</b> 15.03.2018
<b>Lënda:</b>	Konfirmim i ligjshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës	Nr. 020-338
<b>Lloji i aktit</b>	Vendim	

I nderuar Kryetar,  
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 02/51 në parim për themelimin e komiteti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve të luftës së UÇK-së si dhe Martirëve të Luftës
I miratuar më datë: 02.03.2018
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 07.03.2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

<b>Za:</b>	<b>Ragip Begaj</b> , gradonačelnik Opštine Mališevo <b>Rrahim Morina</b> , predsedavajući Skupštine opštine Mališevo	
<b>Cc:</b>	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
<b>Preko:</b>	<b>Ivan Todosijević</b> , ministar MALS-a, <i>za B.A. [signature]</i> <b>Rozafa Ukimeraj</b> , generalna sekretarka MALS-a, <i>[signature]</i>	
<b>Od:</b>	<b>Shkelqim Jakupi</b> , rukovodioca Odeljenja za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS - <i>[signature]</i>	Datum, 15.03.2018
<b>Predmet:</b>	Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine Mališevo	Br. 020-338
<b>Vrsta akta:</b>	Odluka	

Poštovani gradonačleniče,  
Poštovani predsedavajući

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka br. 02/51 u načelu za osnivanje Odbora za porodice palih boraca, invalida, boraca OVK-a, i ratnih mučenika
Usvojena dana, 02.03.2018. godine;
Predložena na razmatranje u MALS-u dana, 07.03.2018. godine;

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je isti u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni učinak. Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



REPUBLICA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

07/03/2018  
02/18  
NYRË SË LIGJIT NË GJYKIMIN  
DHE NË KOSOVËN E PËRITURËN  
REPUBLIC OF KOSOVO  
MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHETËT LOKAL  
Municipality of Local Government Administration  
07-03-2018

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/

Datë: 07.03.2018

Mbështetur në nenin 12 paragrafi 2 pika d, nenin 51 paragrafi 2 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, bazuar në nenin 26 paragrafi 2 dhe 29 paragrafi 1 pika a, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871, datë:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur me datë: 28.02.2018 mori këtë:

VENDIM

NË PARIM PËR THEMELIMIN E KOMITETIT PËR FAMILJE TË DËSHMORËVE  
INVALIDËVE, VETERANËVE TË LUFTËS SË UÇK-SË, SI DHE MARTIRËVE TË LUFTËS

1. Miratohet në parim vendimi për themelimin e Komitetit për familje të Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve të Luftës së UÇK-së, si dhe të Martirëve të luftës në Komunën e Malishevës.
2. Bazuar në pikën 1 të këtij vendimi Komiteti për familje të Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve të Luftës së UÇK-së si dhe të Martirëve të luftës do të jetë në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve.  
Dy (2) anëtar nga radhët e Nisma Socialdemokrate  
Një (1) anëtar nga radhët e PDK-së  
Një (1) anëtar nga radhët e LDK-së  
Një (1) anëtar nga radhët e VV-së  
Dy (2) anëtar nga Shoqatat të dala nga lufta e UÇK-së
3. Komiteti për familje të Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve të Luftës së UÇK-së si dhe të Martirëve të luftës duhet të hartojë planin e punës për vitin 2018, ndërsa pagesa do të bëhet vetëm për gjashtë (6) mbledhje të rregullta.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kuvendi përmes Kryetarit të Komunës dhe drejtorisë për Buxhet dhe Financa.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet;  
Arkivit të Komunës  
MAPL-së.

Kryesuesi i Kuvendit  
Rajrim Morina



*[Handwritten signature]*



Për: Kuvendin Komunal në Malishevë

Ce: Rrahim Morina, Kryesues i Kuvendit Komunal në Malishevë

Nga: Alban Krasniqi, Anëtar i Kuvendit Komunal në Malishevë

Data: 27.02.2018

PROPOZIM  
27/02/2018  
02/31

**Lënda: Propozim për themelimin e komitetit për familje të dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës së UÇK-së si dhe të martirëve të luftës**

Të nderuar,

Komuna e Malishevës është një nga zonat e cila ka dhënë kontribut të çmueshëm gjatë luftës së UÇK-së gjatë së cilës janë mobilizuar mbi 2500 luftëtarë, ku 73 nga ata kanë rënë dëshmorë, mbi 260 janë invalidë të luftës, duke mos harruar këtu edhe qindra martirë të vrarë gjatë luftës dhe shkatërrimet masive të shtëpive dhe pasurisë së qytetarëve të Malishevës.

Deri me tani ndonëse çështjet që ndërlidhen me këto kategori që meritojnë respekt e përkujdes kanë gjetur deri diku trajtim megjithatë konsideroj të nevojshme një trajtim më dinjitoz të çështjeve që lidhen me këto kategori e të cilat aktualisht janë përfshirë në kuadër të një komiteti i cili për nga fushë veprimtaria është shumë i gjerë dhe i trajton këto kategori në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale duke e minimizuar rëndësinë e një periudhe që meriton fokusin dhe përkujdesjen e duhur institucionale.

Duke e ditur se gjitha çështjet që ndërlidhen me familjet e dëshmorëve, martirëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës, deri me tani janë trajtuar jo mjaftueshëm dhe në mënyrë jo të duhur, mendoj se themelimi i një komiteti të veçantë për këto kategori do të mundësonte trajtimin më korrekt dhe më adekuat për të gjitha çështjeve që ndërlidhen me këto kategori të veçanta të shoqërisë sonë.

Themelimi i këtij komiteti si trup e Kuvendit Komunal do të mundësonte që adresimi i kërkesave dhe shqetësimeve të këtyre kategorive të dalë nga lufta të ketë një trajtim serioz dhe të dinjitoshëm.

Ky komitet do të angazhohej në koordinimin e organizimeve për shërimin e përvjetorëve të dëshmorëve, përvjetorëve të ngjarjeve historike, do të trajtonte të gjitha çështjet që ndërlidhen me kategoritë e lartcekura, përfshirë edhe shqyrtimin dhe mbështetjen e iniciativave dhe kërkesave të organizatave që përfaqësojnë këto kategori.

Pra, do të ishte organ i veçantë i Kuvendit Komunal që do të bashkëpunonte ngushtë me gjitha organizatat e dalë nga lufta dhe do të mbroste interesat e këtyre kategorive.

Andaj, në cilësinë e anëtarit të kuvendit Komunal të Malishevës me anë të kësaj shkrese kërkoj nga ju që si anëtarë të Kuvendit Komunal ta përkrahni themelimin e këtij komiteti si trup e kuvendit që do të trajtonte çështjet që kanë të bëjnë me familjet e dëshmorëve, martirëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës.

Me respekt,

Alban Krasniqi, Tel: 044 191 534